



Procesverbal i Takimit të 8-të të Grupit të aktorëve  
për  
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

**25 Nëntor, 2014**  
**Royal L Hotel, v.Carev Dvor,**  
**Komuna e Resnjës, Maqedoni**



## Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 8-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 32 antarë të emëruar dhe të rinj të mundshëm për Rajonin e Prespës. Takimi u organizua dhe u facilitua nga Stafi i Njësise së menaxhimit të Projektit.

Lista e plote e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

**ANNEX 1:** Lista e pjesëmarrësve të takimit të 8-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 25.11.2014

**ANNEX 2:** SCAN Lista e pjesëmarrësve të takimit të 8-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 25.11.2014

## Programi i takimit:

09:30 - 10:00 **Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes**

10:00 – 10:10 **Fjalimi i mirëseardhjes**

Z. Goko Strezovski, Kryetari i Komunës së Resnjës

10:10 – 10:20 **Hapja zyrtare dhe prezantimi i programit**

Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

10:20 – 10:50 **Prezantimi i broshurave të përgatitura për promovimin e rajonit “Prespa” dhe promovimin e rajonit në aktivitete të tjera**

Z. Krste Micalovski, Komuna Resnjë

Z. Damjan Surlevski, Koordinator Rajonal – “Prespa” CBR

Znj. Etleva Thimo, Asistente Teknike – “Prespa” CBR

10:50 – 11:30 **Progresi i realizuar i “Njerëzit për Njerëzit” dhe diskutim mbi hapat e ardhshëm**

Z. Damjan Surlevski, Koordinator Rajonal – “Prespa” CBR

11:30 - 12:00 **Pushim kafe**

12:00 – 13:30 **Diskutim për fazën e ardhshme të programit ABDA**

Znj. Irena Dzimrevska, Shefe Operacionale e SWG

13:30 – 14:00 **Konkluzionet e takimit**

Z. Damjan Surlevski, Koordinator Rajonal – “Prespa” CBR

14:00 - 15:00 **Dreka**

15:00 **Kthimi**



## Procesverbal i takimit

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes nga Koordinatori Rajonal për rajonin ndërkufitar "Prespa" Z. Damjan Surlevski, i cili falenderoi pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim sa më të frutshëm me të gjithë aktorët.

Më pas në emër të Komunës Resnjë, komunës pritëse të takimit, përshëndeti kryetari i kësaj komune Z Goko Strezovski. Z. Strezovski shprehu kënaqësinë për përfshirjen në aktivitetet të tilla të rëndësishme për rajonin dhe njëkohësisht përgjegjësinë dhe gadishmërinë maksimale të komunës për bashkëpunim në kuadër të projektit ABDA.

Në vazhdim Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" dhe Z.Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" pasi përshëndetën pjesëmarrësit prezantuan në detaje programin e takimit duke u ndalur në cdo sesion të programit.

### Sesioni 1

#### **Prezantimi i broshurave të përgatitura për promovimin e rajonit "Prespa" dhe promovimin e rajonit në aktivitete të tjera.**

Sesioni nisi me prezantimin e Z. Krste Micalovski, mbi promovimin e rajonit Prespa në panairin Euregia 2014, Leipzig, Gjermani. Z. Micalovski dha detaje të këtij panairi duke u ndalur në rëndësinë dhe fokusin e këtij takimi. Pjesëmarrës në panair ishin përfaqësues nga gjithë rajonet e, ku si qëllim kryesor ishte shkëmbimi i eksperiencës dhe informacionit me qëllim bashkëpunimin me rajonet e tjera. Pjesëmarrja në Euregia 2014 ishte një mundësi për prezantimin e metodologjisë ABDA (qasja bazuar në zhvillimin e territoreve) në Ballkanin Perëndimor dhe po ashtu edhe e rajoneve ndërkufitare të "Prespës", "Sharës", "Drina-Tara" dhe "Drina-Sava". Euregia 2014 mundësoi prezantimin e platformës të ideve novative, koncepteve, përfundimeve studimore dhe shembujve të praktikave më të mira për zhvillimin lokal dhe rajonal si edhe mundësive për bashkëpunim dhe partnership-eve të reja.

Më pas Z. Damjan Surlevski bëri një prezantim të broshurave të përgatitura për promovimin e rajonit Prespa. Kështu, ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për realizimin e tyre së bashku me kontributin e sugjerimeve dhe komenteve të grupit të rajonit ndërkufitar Prespa.

Në vazhdim të takimit aktorë të ndryshëm dhanë komente, sugjerime dhe pyetje të ndryshme.

Kështu, antarë të grupit vlerësuan punën e bërë mbi realizimin e broshurave, rëndësinë që ato kanë në promovimin e rajonit duke sugjeruar që broshurat të mund të përkthehen edhe në gjuhët e rajonit, shqip dhe maqedonisht. Gjithashtu u theksua edhe rëndësia e të paturit në formë elektronike të broshurave me qëllim që të mund të shpërndahen edhe në faqe të tjera të internetit duke rritur kështu vizibilitetin nga më shumë persona dhe promovimin më të gjërë të rajonit. Kështu në vazhdim të kësaj ideje, u sugjerua hapja e një faqeje në rrjetet sociale si facebook, e cila të menaxhohet së bashku me zyrën e Korçës dhe grupin e aktorëve. Qëllimi i kësaj



fajeje në internet u sugjerua të jetë pasqyrimi i aktiviteteve dhe punës, që grupi i aktorëve së bashku me SWG kanë realizuar për rajonin ndërkufitar Prespa.

Po kështu në vazhdim të sugjerimit mbi promovimin e rajonit dhe aktiviteteve që grupi realizon u sugjerua që vazhdimisht të organizohen prezantime edhe në media të ndryshme lidhur me punën dhe aktiviteteve që realizohen në bashkëpunim me SWG me qëllim rritjen e promovimit edhe me gjere.

Gjithashtu gjatë sesionit të parë u sugjerua që pjesëmarrja në këto takime të jetë edhe më e madhe, duhet të mbulohen edhe kostot e transportit të udhëtimit, pasi kjo shërben si faktor negativ duke penguar një sërë aktorë të mos frekuentojnë rregullisht këto takime kaq të rëndësishme.

Në përgjigje të komenteve, sugjerimeve dhe pyetjeve, lehtësuesit e takimit falenderuan pjesëmarrësit për diskutimet dhe dhanë mbështetjen për vazhdimin e bashkëpunimit. Kështu ata vlerësuan idetë dhe komentet konkrete duke theksuar mbështetjen maksimale nga ana e projektit për realizimin sa më të mirë të tyre. Gjithashtu u vlerësuan diskutimet konstruktive për përpjekjen e gjetjeve të sugjerimeve mbi rritjen e bashkëpunimit mbi promovimin e rajonit. Kështu u theksua mbështetja nga ana e organizatës për mundësimin e broshurave në gjuhët e rajonit, shqip dhe maqedonisht. Gjithashtu mbështetje u sigurua edhe për mundësimin në formë elektronike të broshurave dhe printimin e tyre nga ana e antarëve të grupit për qëllime promovuese duke theksuar gjithmonë mundësimin e tyre si rezultat i bashkëpunimit të grupit të aktorëve me SWG.

## **Sesioni 2**

### **Progresi i realizuar i “Njerëzit për Njerëzit” dhe diskutim mbi hapat e ardhshëm**

Përmes prezantimit të tij Z.Damjan Surlevski theksoi rëndësinë që kanë veprimet e ndërmarrja “Njerëzit për Njerëzit” duke u ndalur edhe në progresin dhe veprimet e ndërmarrja deri tani. Në prezantimin e programi “Njerëzit për Njerëzit” fokus ju dha edhe njëherë jo vetëm rëndësisë dhe bashkëpunimit mes aktorëve, por edhe kriterëve dhe veprimeve që mund të mbështeten përmes këtij programi. Kështu këto veprime kanë qënë një mundësi shumë e mirë e promovimit të rajonit Prespa, duke ju dhënë mundsinë aktorëve të grupit të palëve të interesuara të shkëmbejnë njohuritë dhe informacione duke promovuar dhe shitur produkte ne tregun rajonal. Kështu festivali i verës dhe i djathit, por edhe festivali i mollës u përmendën si shembull i suksesshem i realizuar përmes programit “Njerëzit për Njerëzit”. Këto festivale kanë mbledhur së bashku prodhues dhe organizata të ndryshme duke ju dhënë mundësinë promovimit të produkteve ushqimore tradicionale, bujqësisë, produkteve artizanale si edhe ne vendosjen dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal.

Në diskutimet e ndryshme të realizuara nga aktorët pjesëmarrës u theksua rëndësia e zhvillimit të bujqësisë si edhe ndërgjegjesimi për shfhtëzimin e burimeve në rajon. Gjithashtu sugjerime u dhanë edhe në lidhje me realizimin e workshop-eve apo forumeve ekonomike së bashku edhe me mbështetjen e e SWG dhe instituconve



nga Komuna e Resnjës dhe Qarku Korçë për të aplikuar me qëllim promovimin e rajonit.

Gjithashtu një koment tjetër ishte edhe lidhur me rëndësinë e ndërhyrjes në infrastrukturë, e cila ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin turistik dhe promovimin e rajonit.

Kështu në përmbledhje të diskutimeve dhe komenteve, lehtesues të takimit theksuan si shumë të vlefshme idetë e dhe siguruan mbështetjen e tyre në realizimin e forumeve apo workshop-eve të ndryshme. Gjithashtu në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës duke parë pamundësinë financiare që kanë Komunat si mundësi e ndërhyrjes mund të vlerësohet edhe programit IPARD II i cili është në fazë përgatitjeje dhe mund të jetë një mundësi konkrete e cila mund të shfrytëzohet nga rajonet ku ka nevojë.

### **Sesioni 3**

#### **Diskutim për fazën e ardhshme të programit ABDA**

Në fillim të këtij sesioni Znj. Irena Dzimrevska bëri një prezantim të organizatës SWG dhe formimit, duke u ndalur më pas në prioritetet, fokusin dhe bashkëpunimin me rajonet ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor. Kështu ajo prezantoi çështje mbi vazhdimin e aktiviteteve përgatitore për implementimin e ABDA, testimin në praktikë e ABD me zbatimin e metodologjise së integruar të zhvillimit ekonomik në rajonet ndërkufitare "Drina - Tara" dhe "Drina - Sava", pilotimin e skemave të grandeve si edhe perspektiva për të ardhmen e programit. Përsa i përket gjëndjes aktuale u theksuan ndryshimet thelbësore në qasjen e menazhimit të IPA drejt projekteve të mëdha ose financimin nëpërmjet instituteve të mëdha financiare. Më pas prezantimi vazhdoi me informimin rreth Forumit të Politikave Bujqësore (FPB) 2014 dhe zhvillimit ekonomik rural të rajoneve ndërkufitare ku implementohet metodologjia ABD. Kështu FPB rekomandon që të vazhdohen aktivitetet që rrisin zhvillimin e kapaciteteve sipas qasjes ABD, të kërkohet për financime alternative duke përfshirë IPARD dhe programet CBC, të krijohet bashkëpunim me nismat e tjera rajonale për aktivitete të përbashkëta si edhe i bëhet thirrje Ministrive të Bujqësisë për të përfshirë parimet ABD në politikat kombëtare zhvillimore rurale. Në konkluzionet e prezantimit u theksua se strukturat janë krijuar dhe funksionojnë, dokumentet e programimit janë të përgatitur dhe dorëzuar në KE, aktorët rajonalë janë duke pritur fillimin e fazës së zbatimit, ABDA është përfshirë në IPA II në dokumentin e strategjisë treguese 2014-2020 dhe se burimet financiare aktualisht nuk janë të alokuara për financimin e projekteve ABDA në kuadër të IPA II.

Në diskutimet e realizuara mbi sesionin e tretë antarë të grupit të palëve të interesuara theksuan se edhe pse prespektiva për të ardhmen nuk ishte sic pritej u shprehën se ky moment i vështirë do i motivojë ata për të qëndruar bashkë si grup edhe në të ardhmen. Kështu u sugjerua që në vazhdim zyra e SWG, por edhe vetë



antarë të grupit të identifikojnë partnerë potencialë të mundshëm për të aplikuar mbi programe të reja. Gjithashtu u theksua edhe veshtirësia që hasin disa nga antarët e grupit për të aplikuar në projekte si IPA. Kështu ata shprehën nevojën për ngritjen e kapaciteteve për shkrimin e projekt propozimeve që kërkojnë projekte të tilla.

Në përgjigje të komenteve nga antarë të grupit, lehtësuesit e takimit vlerësuan sugjerimet e pjesëmarrësve dhe mbështetën maksimalisht komentet e tyre mbi nevojat që ata kanë dhe bashkëpunimin për vazhdimësinë.

## **Sesioni 4**

### ***Konkluzione dhe mbyllja e takimit***

Në sesioni e fundit pasi u realizua një përmbledhje e prezantimit të programit të takimit dhe çështjeve të diskutuara u dhanë edhe konkluzionet si mëposhtë:

- Broshurat do të shpërndahen në formë elektronike si dhe do të bëhen përpjekje nga secili prej antarëve të grupit (SHG) për promovimin e tyre në faqet web që ata disponojnë ose në media të tjera.
- Broshurat do të përkthehen në gjuhët lokale (Maqedonisht dhe Shqip) sipas sugjerimit të anatrëve të grupit.
- Secili nga antarët e grupit (SHG) do të marrë një sasi të materialeve të përgatitura promovuese sipas fushës së interes dhe zonës operuese.
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të mbështesë idetë dhe do të ndihmojë në koordinimin e aktiviteteve potenciale që mund të mbështeten nga programi “Njerëzit për Njerëzit”.
- Më qëllim promovimin e aktiviteteve dhe punës së bërë nga antarët e grupit të palëve të interesuara (SHG), është e nevojshme krijimi i një platforme për shkëmbimin e informacionit. Gjithashtu krijimi i një faqeje në Facebook do të realizohet për të shpërndarë informacionin me antarë të grupit;
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të bëjë përpjekje përmes takimeve me autoritetet përkatëse, për të theksuar rëndësinë e rindërtimit të infrastrukturës rrugore lokale në rajonin e Prespës;
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” dhe SWG do mund të shërbejë si një pikë informative ku antarët e grupit (SHG) të mund të marrin informacion për thirrje për projekt propozime dhe programe dhe mund të lehtësojë procesin e bashkëpunimit për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta në rajon;



- Nevoja për rritjen e vizibilitetit të aktiviteteve të programit ABDA do të mbështetet edhe nga antarë të grupit (SHG) me promovimin përkatës në nivel lokal;
- Lidhur me panairin që do të zhvillohet ne Beograd, i cili do të jetë një mundësi shumë e mirë për promovimin e rajonit, të gjithë antarët e grupit (SHG) do të përfshihen në procesin e përzgjedhjes për pjesëmarrjen në Panair.

**Përgatiti:**

Etleva Thimo  
Asistent Teknik  
Rajoni Ndërkufitar Prespa

